



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency

Data: 16.04.2019  
Ref.: A Nr. 12/2019  
618/130

**Komisioni Ankesave i Agjencisë së Kosovës për Akreditim**, në përbërje të plotë dhe në praninë e procesmbajtësit, në shqyrtimin e ankesës me numër protokollit 443/19H të datës 18.03.2019, të parashtruar nga BprAL Kolegji “Universi” në Prishtinë, të parashtruar kundër Vendimit Nr. Ref. 306/19D, datë 25.02.2019 të Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë së Kosovës për Akreditim, duke vepruar në bazë të neneve 47, 48 dhe 132 (paragrafi 4) të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare Nr. 20 / 21 qershor 2016) si dhe duke vepruar në pajtim me nenin 22 paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (datë 28.09.2018) si dhe neneve 5, 8 dhe 14 të Rregullores Nr. 2/2019 për Funksionimin e Komisionit të Ankesave të Agjencisë së Kosovës për Akreditim, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 16.04.2019, mori këtë:

## V E N D I M

1. **Aprovohet si e bazuar** ankesa me numër protokollit 443/19H të datës 18.03.2019, e parashtruar nga BprAL Kolegji “Universi” në Prishtinë.
2. **Anulohet** Vendimi Nr. Ref. 306/19D, datë 25.02.2019 i Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë së Kosovës për Akreditim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari Komisionit.

## A r s y e t i m

Pas deklarimit të stafit akademik të IAL-ve sipas nenit 30 të UA për Akreditim, AKA ka filluar me verifikimin e dokumentacionit të tyre me qëllim të konfirmimit të plotësimin apo jo të kriterëve ligjorë për secilin program të studimit. Në mbledhjen e mbajtur me 15 dhe 16 janar 2019, KShC ka analizuar dokumentacionin e secilit staf akademik të vendosur si bartës të programeve nga Kolegji Universi dhe pasi ka analizuar të dhënat rreth numrit të stafit dhe fushat e studimit për secilin program të studimit, KShC me Vendimin Nr. Ref. 306/19D, datë 25.02.2019 ka tërhequr akreditimi i programit të studimit Infermieri e Përgjithshme BSc, 180 ECTS, të Kolegjit “Universi”.

Parashtruesi i ankesës BprAL Kolegji “Universi” në Prishtinë, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesën me numër protokollit 443/19H të datës 18.03.2019, të parashtruar kundër Vendimit Nr.

Ref. 306/19D, datë 25.02.2019 të Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë së Kosovës për Akreditim, me të cilin vendim është tërhequr akreditimi i programit të studimit Infermieri e Përgjithshme BSc, 180 ECTS, të Kolegjit "Universi".

KShC bazuar në nenin 131 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, pa u shprehur mbi të, të njëjtën e ka referuar për vendimmarrje në Komisionin e Ankesave të AKA-së dhe atë bazuar në paragrafin 5 të nenit 131 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

**Administrimi i provave:** Komisioni i Ankesave i AKA-së ka administruar këto prova:

- Ankesën me numër protokolli 443/19H të datës 18.03.2019, të parashtruar nga BprAL Kolegji "Universi" në Prishtinë.;
- Vendimin Nr. Ref. 306/19D, datë 25.02.2019 të Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë së Kosovës për Akreditim për tërheqje të akreditimit për programin e studimit Infermieri e Përgjithshme BSc, 180 ECTS ;
- Vendimin Nr. Ref. 455/18D, datë 18.05.2018 të Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë së Kosovës për Akreditim, me të cilin është zgatur periudha e akreditimit për programin e studimit të Infermieri e Përgjithshme BSc, 180 ECTS, të Kolegjit Universi, për periudhen një (1) vjeqare 1 tetor 2019-30 shtator 2020.

KShC me Vendimin Nr. Ref. 306/19D, datë 25.02.2019, ka arsyetuar si në vijim:

1. **"Për programin e studimit: Infermieri e Përgjithshme, BSc, 180 ECTS, si bartës të këtij programi Kolegji Universi ka paraparë këta persona: Behrije Halilaj Vishi, Afërdita Berisha dhe Minire Alilaj.**

*Ky program ka 180 ECTS dhe rrjedhimisht sipas Nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, për këtë program të studimit Kolegji Universi, duhet të ketë të paktën tre staf akademik me gradën akademike PhD me marrëdhënie të rregullt të punës nga fusha e programit të studimit.*

*Sipas Nenit 26, pika 5.3.11 e UA për Akreditim, "Programet e studimit me mungesë të stafit akademik me gradën Dr.sc., ashtu siç është paraparë në këtë UA, (Infermieri BSc, Mami, BSc dhe Gjuha e Shenjave BSc), do të lejohen të hyjnë në procedurë të vlerësimit dhe akreditimit, me kusht që institucioni i arsimit të lartë do të siguron AKA-në që ka marrëveshje të bashkëpunimit me të paktën një institucion ndërkombëtar të arsimit të lartë i cili në vendin e tij të origjinës është i akredituar". Përveç asaj çka u tha me sipër IAL-të duhet te kenë staf permanent nga fusha e studimit, te paktën me gradën MA.*

*Pas kontrollimit të dokumentacionit rreth kualifikimit të stafit akademik të vendosur nga Kolegji Universi për programin e studimit, Infermieri e Përgjithshme, BSc, 180 ECTS, është konstatuar që: Behrije Halilaj-Vishi është MA në Menaxhment Shëndetësor, Afërdita Berisha, MA në Menaxhment Shëndetësor, dhe Minire Alilaj, PhD Shkenca Obstetrike dhe Gjinekologjike. Bazuar në dëshmitë e kualifikimit, është konstatuar që asnjëri nga tre të përmendurit më sipër nuk kanë kualifikim në fushën e infermierisë, andaj mbi këtë bazë nuk i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë bartës të këtij programi të studimit.*

*Andaj bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara me lartë, KShC vendosi që në mungesë të stafit akademik për këtë program të studimit sipas pikës 5.3.4 dhe 5.3.11 të Nenit 26 dhe bazuar në pikën dy (2) të Nenit 21 të Udhëzimit*

*Administrativ për Akreditim, të tërheq akreditimin për programin e studimit Infermieri e Përgjithshme, BSc, 180 ECTS.”*

**Komisioni i Ankesave i AKA-së** pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjitha shkresave dhe provave të lëndës si dhe pretendimeve të palës ankuuese, ka konstatuar se **është i pa bazuar** Vendimi i KShC-së Nr. Ref. 306/19D, datë 25.02.2019 me të cilin vendim është tërhequr akreditimi i programit të studimit Infermieri e Përgjithshme BSc, 180 ECTS, të Kolegjit “Universi” dhe se KShC nuk ka aplikuar drejtë nenin 21, pika 2 e Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr. 15/2018, me ç’rast Komisioni Ankesave konstatoi se kushtet e dhëna me rastin e akreditimit nuk janë shkelur nga BprAL Kolegji “Universi”.

Po ashtu Komisioni ka konstatuar se KSHC nuk ka marrë parasysh vendimin paraprak (Nr. Ref. 455/18D, datë 18.05.2018) për zgjatje të akreditimit për një vit, ku bartës të programit kanë qenë stafi me përgatitje të njëjtë, përjashtimisht njërit staf të ri, dhe atë Minire Alijaj PhD Shkencat Obstetrike dhe Gjinekologji, e cila sipas vlerësimit të Komisionit të Ankesave, e njëjta nuk është jashtë fushës së mjekësisë, përkundrazi e ka titullin Dr.Sc në Shkencat Obstetrike dhe Gjinekologjike, e cila ka zëvendësuar stafin paraprak Miradije Kica, Msc në Menaxhim Shëndetësor.

Komisioni Ankesave i AKA, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, provave të ofruara, si dhe analizimit të të gjitha pretendimeve të palës ankuuese, ka konstatuar se pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës **janë të qëndrueshme dhe të bazuara**, andaj duke u bazuar në kompetencat e Komisionit të Ankesave, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshilla juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ në gjykatën kompetente (Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Vendimi i Komisionit të Ankesave është përfundimtar dhe se inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndal ekzekutimin e këtij vendimi.

### **Komisioni Ankesave i Agjencisë së Kosovës për Akreditim**

**Lënda me numër A Nr. 12/2019**

Datë: 16.04.2019


**Kryetari i Komisionit:**

**Shykrane Gërmizaj**



**Procesmbajtësi:**

**Iliriana Ademaj-Ahmeti**



Vendimi i dërgohet:

- Palës ankuuese;
- Agjencisë së Kosovës për Akreditim;
- Arkivit.